



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 1347/prot.

Tiranë, më 15.07.2019

UDHËZIM

Nr. I, datë 15.07.2019

PËR

**PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE STANDARDE PËR TRAJTIMIN E KËRKESAVE
PËR MENDIM MBI PROJEKTAKTE TË ARDHURA NGA ORGANET SHTETËRORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; germës “f”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

1. Përcaktimin e procedurës standarde për trajtimin e kërkesave për mendim mbi projektakte të dërguara nga institucione të administratës shtetërore ose nga organe të tjera shtetërore.
2. Kërkesat e ardhura nga organet e sipërcituara, në formë shkresore, pasi të protokollohen do të dërgohen pranë Kabinetit të ministrit, i cili do të bëjë përcjelljen e këtyre praktikave pranë Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, brenda ditës së marrjes në dorëzim.
3. Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore merr masa që, brenda ditës së punës në të cilën njihet me projektaktin e ardhur për mendim, ta përcjellë atë pranë strukturave të Ministrisë, Forcave të Armatosura apo strukturave të tyre të varësisë, që preken nga rregullimet e propozuara në projektaktin e ardhur për mendim ose që kanë në fushën e tyre të kompetencës njohuri teknike të cilat mundësojnë dhënien e mendimeve dhe sugjerimeve mbi projektaktin.
4. Në rastet kur projektakti dërgohet nëpërmjet sistemit e-akte, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, brenda 1 dite pune e përcjell pranë strukturave, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 3, më anë të postës elektronike zyrtare.

5. Strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij udhëzimi, brenda 2 ditësh pune nga marrja e kërkesës për mendim nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, duhet të prononcohen duke dhënë dakordësinë ose duke shprehur sugjerimet/kundërshtimet e tyre mbi projektaktin.
6. Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, pas mbledhjes së prononcimeve nga strukturat, sipas pikave të mësipërme, i sintetizon në një mendim të unifikuar, i cili përbën edhe qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes mbi projektaktin e ardhur për mendim.
7. Pas përgatitjes së mendimit zyrtar, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore përgatit praktikën e plotë dhe e përcjell për miratim te autoriteti në emër të të cilit është përgatitur përgjigja.
8. Për të bërë të mundur zbatimin e afateve ligjore dhe nënligjore për dhënien e mendimit, afati mund të ndryshohet nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, duke parashikuar një afat tjetër në kërkesën drejtuar strukturave të përcaktuara në pikën 2 të këtij udhëzimi.
9. Specifikisht për projektaktet të cilat kanë lidhje me çështjet e pronave, prononcohet brenda afateve drejtoria përgjegjëse për menaxhimin e pronave në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, nëpërmjet drejtorit të Shtabit dhe në mungesë të tij nëpërmjet drejtorit të J-3/7.
10. Ngarkohen të gjithë drejtoritë e Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, të gjitha strukturat e vartësisë, drejtoritë rajonale në varësi të tyre, për zbatimin e këtij udhëzimi.
11. Ndjek zbatimin e këtij udhëzimi sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.
12. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.


MINISTRI
Ota Knaçka
Ota Knaçka